



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 6 Datë 07.03.2018

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “TRADITA GEG & TOSK” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pikës 2, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim (miratim në parim) të subjektit “TRADITA GEG & TOSK” sh.p.k., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe opionencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**TRADITA GEG & TOSK**”sh.p.k., me administrator Z.Sami BRAHIMI, për përdorim të burimeve ujor **Përroi Kroj i Borshit dhe Përroi i Bicës**, (degë të Lumit të Shalës) për prodhim energjie elektrike në fshatin Gimaj, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC ERA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes nr.1: (Kroi Borshit) $X_1 - 43\ 99\ 381$; $Y_1 - 46\ 86\ 660$; $Z_1 - + 650\ m$;
Koordinatat e veprës së marrjes nr.2: (Kroi Borshit) $X_2 - 43\ 98\ 907$; $Y_2 - 46\ 87\ 183$; $Z_2 - + 650\ m$;
Koordinatat e veprës së marrjes nr.3: (Përroi Bicës) $X_3 - 43\ 98\ 107$; $Y_3 - 46\ 87\ 847$; $Z_3 - + 750\ m$;

Koordinatat e Burimit 1. Kaptazhit 1: $X_1 - 43\ 98\ 832$; $Y_1 - 46\ 87\ 495$; $Z_1 - + 635\ m$;

Koordinatat e Burimit 2. Kaptazhit 2: $X_2 - 43\ 99\ 071$; $Y_2 - 46\ 87\ 419$; $Z_2 - + 603\ m$;

Koordinatat e godinës së centralit: $X - 43\ 99\ 153$; $Y - 46\ 87\ 979$; $Z - + 510\ m$;

Koordinatat e pikës së shkarkimit: $X - 43\ 99\ 153$; $Y - 46\ 87\ 979$; $Z - + 510\ m$;

Prurja mesatare vjetore e burimeve: $Q_{1mes} = 0.153\ m^3/sek$; $Q_{2mes} = 0.044\ m^3/sek$; $Q_{3mes} = 0.404\ m^3/sek$;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: $Q_{llog} = 0.725\ m^3/sek$;

Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.113\ m^3/sek$;

Prurja që shkarkohet: $Q = 0.725\ m^3/sek$.

2- Autorizimi (miratimi në parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

